

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5926
E shtunë, 9 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Shumica e grave
deputete siguruan ulëse
në Kuvend pa kuotë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA | FAQE 4-5

NUK LEJOJMË QË TË TJETËRSOHEM VULLNETI I 42 MIJË QYTETARËVE

Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka vlerësuar se zgjedhjet e 6 tetorit kanë qenë më të manipuluarat sesa zgjedhjet e vitit 2010. Ai ka thënë se këto zgjedhje janë nul dhe pasojat e tyre do të jenë shumë më të mëdha sesa që mendohen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se Nisma e ka kaluar

pragun, por grupet mafioze me votat e kontrabanduara dhe të kundërligjshme të Vuçiqit dhe të Daçiqit po duan ta lënë jashtë Kuvendit. Mirëpo ai ka thënë se një gjë e tillë nuk do të ndodhë meqë do t'i ndjekin të gjitha procedurat ligjore, deri në Gjykatën Kushtetuese, që të mos tjetërsohet vullneti i më shumë se 42 mijë qytetarëve



Shkruan:
Ismail SYLA



OPINION

USHTRIA ÇLIRIMTARE E
KOSOVËS DHE HAGA | F. 10-11

AKTUALE

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
PROMOVON 14 DOKTORANTË
TË RINJ | F. 5

MINISTRI BYTYQI ANULON
VENDIMIN PËR MBËSHETJEN E
STUDENTËVE ME BURSA | F. 7

EKONOMI



PUNËTORËT E 'INFRAKOS'-it
KËRKOJNË PAGAT E VETA | F. 9

BE-ja INVESTON 700 MIJË EURO
PËR FUQIZIMIN E ZYRËS SË
AUDITIMIT NË KOSOVË | F. 9

SPORT



LLAPI KËRKON FITOREN E DYTË
NDAJ PRISHTINËS | F. 9

Mustafa thotë se me LV-në do ta diskutojnë edhe çështjen e presidentit



Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se negociatat me Lëvizjen Vetëvendosje për harmonizimin e programit qeverisës janë duke shkuar mirë. Pas mbledhjes së Kryesisë së LDK-së ai ka thënë se takimet e nivelit të lartë të dy partive do të vazhdojnë pas certifikimit të rezulttit të zgjedhjeve të 6 tetorit. Sa i takon pozitës së presidentit, Mustafa ka thënë se kjo çështje duhet të vendoset tani në mes të partnerëve të koalicionit

**EKSPERTËT
ZVICERANË
HEDHIN POSHTË
KONSTATIMET E
INSTITUCIONEVE
KOSOVARE PËR
RASTIN 'ASTRIT
DEHARI'** | FAQE 3



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Merkel dhe Leyen: Do t'i ofrojmë Shqipërisë dhe Maqedonisë rrugë alternative

BERLIN, 8 NËNTOR - Presidentja e zgjedhur e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen deklaroi se është shumë e një rëndësie kyçe që Ballkani të lidhet sa më shumë që të jetë e mundur me BE-në. Sipas Politico-s, von der Leyen deklaroi se çelja e një ruge të anëtarësimit në BE për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ka "peshë të madhe strategjike" për bllokun. Deklarata e saj erdhi pas një takimi të zhvilluar me kancelaren gjermane Angela Merkel në Berlin. Von der Leyen që pritet ta nisë mandatin më 1 dhjetor, deklaroi se

Shkupi dhe Tirana kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme për t'i përmbushur kërkesat që BE-ja ka pasur për ta, dhe shtoi se ajo vetë do të kërkojë mënyra alternative për të forcuar lidhjet me të dy vendet. "Për sa kohë që nuk është e mundur të çelen bisedimet e anëtarësimit, unë do të përdor të gjithë energjinë time për zhvillimin e projekteve të përbashkëta që do t'i lidhin gjithmonë e më shumë këto vende me bllokun përmes një bashkëpunimi të ngushtë," ka deklaruar Von der Leyen. "Nëse nuk bëjmë këtë, të tjerët do

të shfrytëzojnë këtë vakum dhe ne nuk duam që kjo të ndodhë", tha ajo. Nisja e mandatit të shefes së re të Komisionit Evropian është vonuar pas refuzimit të tre kandidatëve për komisionarë. Një ditë më parë, ai që bllokoi dritën jeshile për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, presidenti francez Emmanuel Macron theksoi edhe një herë se Bashkimit Evropian i duhet të reformojë njëherë procedurat e anëtarësimit përpara ara se t'i hapë negociatat me të dy vendet.



Palmeri: Evropa po largohet nga Ballkani, ShBA-ja po afrohet

I dërguari i Departamentit amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer ka thënë se ShBA-ja vazhdon të jetë e angazhuar në perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor që ka qenë themeli për angazhimin amerikan në rajon për më shumë se 20 vjet dhe kjo nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Në Gjenevë të Zvicrës po mbahet forumi i Davosit nga ku ka folur edhe i dërguari i Departamentit amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer. Zyrtari i lartë amerikan është shprehur se Evropa duhet ta rishikojë vendimin e saj dhe sa më parë t'i hapë negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ai në forumin Ekonomik në Davos ka folur edhe për 'mini shengenin ballkanik' dhe hapjen e negociatave. "ShBA-të vazhdojnë të jenë të angazhuar në perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor që ka qenë themeli për angazhimin amerikan në rajon për më shumë se 20 vjet. Kjo nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë.

Kjo është edhe arsyeja pse pamundësia e Këshillit Evropian për të gjetur konsensus dhe t'i fillojë bisedimet për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë ishte kaq zhgënjyese, ka thënë Palmer. Ai ka theksuar se kjo nuk është fjala e fundit. "Shpresojmë që Këshilli i Evropës t'i rikthehet çështjes në mbledhjen e liderëve në maj, në Zagreb, të arrijë konsensusin e duhur dhe të nisë atë proces aq të rëndësishëm duke dërguar sinjalin e rëndësishëm në rajon. Ndërkohë, ndërsa ShBA-ja avancojnë drejt Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimi Evropian konsiderohet deri në një farë niveli nga rajoni si duke u larguar, rajoni vetë po zhvillohet. Angazhimi i Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe



Shqipërisë të promovojnë bashkëpunimin përmes së ashtuquajturës nisma e 'mini shengenit' është shpresëdhënëse, është një tregues që liderët në rajon po marrin përgjegjësi për fatin e tyre, po marrin në dorë të ardhmen e vet. Arkitektura e kësaj nisme ka një skaj të hapur, ka vend për Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën. Nisma është premtuese, ka mbështetjen tonë dhe angazhimin tonë

për të bashkëpunuar me liderët e Ballkanit Perëndimor për ta çuar përpara", ka thënë Matthew Palmer. Palmer, ka bërë sërish thirrje për një dialog midis opozitës dhe mazhorancës në Shqipëri për arritjen e një marrëveshjeje për reformën zgjedhore. "Është e rëndësishme që themelet demokratike të Shqipërisë janë të forta, që zgjedhjet janë të lira dhe që populli shqiptar ka lirinë të

zgjedhë në mënyrë demokratike", u shpreh Palmer. Sipas Palmer, kjo marrëveshje çon sërish drejt normalitetit demokratik shqiptar. "Prandaj do na pëlqente të shihnim një dialog që sjell si rezultat një marrëveshje mbi reformën zgjedhore që zbaton rekomandimet e OSBE/OHDIR-it dhe një drejtim që çon sërish drejt normalitetit për demokracinë shqiptare", tha Palmer.

Basha: Neroni i Shqipërisë ka djegur vendin

TIRANË, 8 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha në një takim me qytetarët në Krujë deklaroi se Edi Rama sot ngjan me Neronin, ish-porandorin e Romës. Basha theksoi se Rama, njësoj si Neroni dikur, po djeg pjesë të ndryshme të Shqipërisë. "Edi Rama është Neroni i Shqipërisë, ka djegur shumë në

Shqipëri. Makroni tha se ndëshkova Maqedoninë e Veriut, se doja që të futet bashkë me Shqipërinë. Pse, Maqedonia e Veriut është më mirë se ne? Jo, por vendi ynë ka në krye një njeriu si ky që kemi, që ka shkatërruar gjithçka. Shqiptarët kanë bërë histori shiko futbollin, muzikën. Po ashtu, edhe në juridik, edhe me shkencat,

gjithçka. Shqiptarëve po iu dhe mundësi, janë të parët në sukses", tha Basha. Ai nënvizoi se Rama sot ka lënë në baltë artin e kulturën e se kur PD-ja të jetë në qeverisje do të shtojë vëmendjen ndaj artistëve. "PD-ja si një parti e djathtë konservatore do që të zgjedhurit të jenë sa më pranë. Duhet ndarë

Fushë Krujë nga Kruja. Duhet ndarë, për të pasur mundësi që të jemi më pranë qytetarëve shqiptarë. Edi Rama ka shkatërruar artin e kulturën, duke pasur shumë pak investime për këto fusha. Po ashtu, arti duhet t'iu shkojë artistëve e jo oligarkëve. Arti e kultura do të kenë mbështetje kur ne të vijmë në qeveri", deklaroi Basha.



Mustafa thotë se me LV-në do ta diskutojnë edhe çështjen e presidentit



Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se negociatat me Lëvizjen Vetëvendosje për harmonizimin e programit qeverisës janë duke shkuar mirë. Pas mbledhjes së Kryesisë së LDK-së ai ka thënë se takimet e nivelit të lartë të dy partive do të vazhdojnë pas certifikimit të rezulttit të zgjedhjeve të 6 tetorit. Sa i takon pozitës së presidentit, Mustafa ka thënë se kjo çështje duhet të vendoset tani në mes të partnerëve të koalicionit. Ai ka theksuar se asnjëherë nuk ka kërkuar që të jetë president i vendit, megjithatë për emrin ka thënë se do të vendosë LDK-ja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, pas mbledhjes së Kryesisë së kësaj partie, të mbajtur të premtën, ka bërë me dije se janë informuar nga ekipi negociues i LDK-së me ecurinë e bisedimeve me Lëvizjen

Vetëvendosje për harmonizimin e programit qeverisës. "Kryesia ka vlerësuar se ekipi ynë ka bërë një punë të mrekullueshme dhe të shkëlqyeshme për prezantimin e pjesëve të programit të LDK-së", është shprehur Mustafa në konferencën për medie.

Ai ka thënë se është arritur mjaft shumë për harmonizimin e pro-

gramit qeverisës me Lëvizjen Vetëvendosje. "Do t'i vazhdojmë takimet pas certifikimit të rezultateve në nivelin e lartë, ku do të jem unë dhe nënkryetarët e LDK-së dhe përfaqësuesi i ekipit që ka punuar deri më tani", ka thënë Mustafa, duke shtuar se do të punojnë me Lëvizjen Vetëvendosje për harmonizimin e disa çështjeve që kanë mbetur

për më vonë.

Më tutje, Mustafa ka thënë se LDK-ja do t'i përmbahet zotimit që ka dhënë më herët, se kushdo që i fiton zgjedhjet do t'i takojë pozita e kryeministrit.

I pari i LDK-së ka thënë se në mbledhjen e kryesisë nuk është folur për pozitën ministrale. "Për to do të flasim në një takim që do ta kemi me liderin e Vetëvendosjes", është shprehur Mustafa.

Ndërsa sa i takon pozitës së presidentit, Mustafa ka thënë se kjo çështje duhet të vendoset tani në mes të partnerëve të koalicionit. Ai ka thënë se nëse nuk arrijnë pajtueshmëri për këtë pozitë, vendi mund të shkojë në zgjedhje pas një viti. Në këtë kontekst, Mustafa ka thënë se asnjëherë nuk ka kërkuar që të jetë president i vendit. "Unë në

asnjë rast nuk jam shprehur as nuk kam kërkuar që të jem president i Kosovës. Të tjerët kanë filluar ta bëjnë këtë punë të mëdha dhe ta bëjnë problem, sepse për të do të vendosë partia që i takon, pra që ta propozojë kandidatin për president të ardhshëm të Kosovës. Ai propozim nuk do të bëhet tani, por do të bëhet kur shpallen zgjedhjet për president. Tani për tani ne duhet të merremi vesh që ta kapërcejmë edhe këtë, sepse në qoftë se këtë nuk e bëjmë, atëherë është një bindje e jona se pas një viti do të shkojmë në zgjedhje të reja", ka thënë Mustafa.

Në këtë konferencë për medie, Mustafa ka folur edhe për dialogun me Serbinë dhe taksën. Ai ka thënë se është ihtar i idesë që dialogu me Serbinë të zhvillohet pa kushte.



Lladrovci ftohet nga Gjykata Speciale si dëshmitar

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se ka pranuar ftesë nga Gjykata Speciale. Lladrovci ka thënë se më 19 dhjetor do të intervistohet nga kjo gjykatë në cilësinë e dëshmitarit. "Valës së

ftesave, nga Dhomat e Specializuara, iu bashkova edhe unë, në cilësi të dëshmitarit. Nuk kam informata as dijeni më shumë sesa shkruan në ftesë. Data e dhënies së dëshmisë është më 19 dhjetor 2019. Kurrë në jetë as kam pasur hamendje

e as kam dilemë për drejtësinë e luftës tonë çlirimtare, rrugën e ndjekur deri në çlirim dhe për pastërtinë e saj shembullore. Përjetësisht krenar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës!", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Zafir Berisha

Nuk lejojmë që të tjetërsohet

Anëtari i Kryesisë së Nismës

Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka vlerësuar se zgjedhjet e 6 tetorit kanë qenë më të manipuluarat sesa zgjedhjet e vitit 2010. Ai ka thënë se këto zgjedhje janë nul dhe pasojat e tyre do të jenë shumë më të mëdha sesa që mendohen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se Nisma e ka kaluar pragun, por grupet mafioze me votat e kontrabanduara dhe të kundërligjshme të Vuçiqit dhe të Daçiqit po duan ta lënë jashtë Kuvendit. Mirëpo ai ka thënë se një gjë e tillë nuk do të ndodhë, meqë do t'i ndjekin të gjitha procedurat ligjore, deri në Gjykatën Kushtetuese, që të mos tjetërsohet vullneti i më shumë se 42 mijë qytetarëve

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate dhe ish-kandidati për deputet, Zafir Berisha, të premten ka kritikuar procesin zgjedhor të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto zgjedhje kanë qenë më jokorrekte dhe më të manipuluarat se ato të vitit 2010. "Fushata dhe organizimi i zgjedhjeve fillimisht ka qenë i mirë nga dukja e jashtme, mirëpo me përmbylljen e procesit u pa që ka pasur segmente të caktuara të cilat kanë punuar që këto zgjedhje të jenë më jokorrekte dhe më të manipuluarat sesa zgjedhjet e vitit 2010, duke përfshirë edhe këto të ashtuquajturat gabime teknike, por edhe njerëzit e porositur brenda organizimit të komisionarëve të cilët po del se me qëllim kanë manipuluar votën e qytetarëve. Prandaj, mund të them se zgjedhjet e 6 tetorit janë nul dhe pasojat e këtyre zgjedhjeve kanë me qenë shumë më të mëdha sesa që mendohen", ka deklaruar Berisha.

Ai ka thënë se Nisma e ka kaluar pragun, por grupet mafioze me votat e kontrabanduara dhe të kundërligjshme të Vuçiqit dhe të Daçiqit po duan ta lënë jashtë Kuvendit. Por, sipas Berishës, një gjë e tillë nuk do të ndodhë meqë do t'i ndjekin të gjitha procedurat ligjore deri në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë që të mos tjetërsohet vullneti i më shumë se 42 mijë qytetarëve. "Ne veçse e kemi dorëzuar ankesën në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe varësisht prej rrethanave do t'i ndjekim

procedurat deri në Gjykatën Kushtetuese pasi që e drejta e qytetarit për votë është kategori kushtetuese dhe natyrisht se nuk mund t'ua lëmë individëve dhe segmenteve të caktuara ta tjetërsojnë vullnetin e më shumë se 42 mijë qytetarëve. E vërteta duhet të dalë në shesh. Shpresojmë se, megjithatë, në këtë drejtësi të lodhur dhe të kapur të Kosovës duhet të ketë pak drejtësi", ka theksuar Berisha. Ai ka folur edhe për formimin e qeverisë LV-LDK, për të cilën ka thënë se do të jetë skandaloze. Megjithatë, Berisha ka shprehur skepticizëm se do të mund të formohet koalicioni qeverisës nga këto dy parti.

"Epoka e re": Z. Berisha, çfarë mendimi keni për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit?

Berisha: Fushata dhe organizimi i zgjedhjeve fillimisht ka qenë i mirë nga dukja e jashtme, mirëpo me përmbylljen e procesit u pa që ka pasur segmente të caktuara të cilat kanë punuar që këto zgjedhje të jenë më jokorrekte dhe më të manipuluarat sesa zgjedhjet e vitit 2010. Duke përfshirë edhe këto të ashtuquajturat gabime teknike, por edhe njerëzit e porositur brenda organizimit të komisionarëve të cilët po del se me qëllim kanë manipuluar votën e qytetarëve. Prandaj mund të them se zgjedhjet e 6 tetorit janë nul dhe pasojat e këtyre zgjedhjeve do të jenë shumë më të mëdha sesa që mendohen.

"Epoka e re": Sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së, Nisma nuk e kaloi pragun.

Berisha: Nisma Socialdemokrate është dëmtuar, prandaj ky proces zgjedhor i ka 'meritat'

që Nisma të jetë në këtë situatë. Nisma e ka kaluar pragun, por grupet mafioze që janë brenda institucioneve me votat e kontrabanduara dhe të kundërligjshme të Vuçiqit dhe të Daçiqit po duan ta shfrytëzojnë rastin që ta lënë jashtë Kuvendit, që nuk besoj se do të ndodhë sepse ka një shpresë që në kthinat e drejtësisë së Kosovës ka, megjithatë, drejtësi.

"Epoka e re": Nëse betejën do ta vazhdoni deri në Gjykatën

Kushtetuese, besoni në një vendim të favorshëm për Nismën?

Berisha: Ne veçse e kemi dorëzuar ankesën në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe varësisht prej rrethanave do t'i ndjekim procedurat deri në Gjykatën Kushtetuese pasi që e drejta e qytetarit për votë është kategori kushtetuese dhe natyrisht se nuk mund t'ua lëmë individëve dhe segmenteve të caktuara ta tjetërsojnë vullnetin e më shumë se 42 mijë qytetarëve. E

vërteta duhet të dalë në shesh. Shpresojmë se, megjithatë, në këtë drejtësi të lodhur dhe të kapur të Kosovës duhet të ketë pak drejtësi. Më herët të njëjtat segmente që po duan ta eliminojnë Nismën kanë tentuar të më eliminojnë mua, por Gjykata Supreme pati vendosur në favor të drejtësisë. Duke u nisur nga kjo, edhe në rastin aktual të Nismës gjykata do të vendosë drejt dhe votat kriminale të Serbisë që kanë ardhur të paketuara do të anulohen. Edhe për faktin se kjo nuk

vullneti i 42 mijë qytetarëve

Gjykata Speciale e dëmton të kaluarën e Kosovës

"Epoka e re": Z. Berisha, gjatë këtyre ditëve Gjykata Speciale ka qenë shumë aktive në dërgimin e ftesave ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Një ftesë e tillë së fundi i ka ardhur edhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli. Si e shihni ballafaqimin e ish-luftëtarëve të UÇK-së me këtë gjykatë?

Berisha: Siç e kam thënë që nga fillimi, Gjykata Speciale e dëmton të kaluarën e

Kosovës dhe është gjykatë e njëanshme, që gjykon luftën e drejtë të UÇK-së. Gjykata Speciale ka ardhur si rezultat i raportit të Dick Martit i cili burimet dhe faktet i dorëzon në Serbi dhe në Rusi. Këto fakte tregojnë se kjo gjykatë ka për qëllim që t'i dëmtojë njerëzit e UÇK-së të cilët kanë bërë gjithçka për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. Në anën tjetër, këtë gjykatë po e

shfrytëzojnë për poenë politike një pjesë e njerëzve të pafytyrë, pa dinjitet dhe të pakurizorë. Megjithatë, unë mendoj se e vërteta do të dalë në shesh për atë UÇK-në që ka luftuar deri më 12 qershor të vitit 1999, jo për atë UÇK-në që i ka blerë uniformat nga 20 marka në Shqipëri dhe ka ardhur në Kosovë kur ushtria e Serbisë ka shkuar në Nish.

Kosovës paralajmëron një situatë shumë të rëndë për të ardhmen.

"Epoka e re": Si do të jetë funksionimi i Nismës qoftë brenda apo jashtë Kuvendit pas vendimit eventual të Kushtetueses?

Berisha: Nisma Socialdemokrate natyrisht se do ta vazhdojë angazhimin e vet dhe në Kuvend do të jetë opozitë. Pas raporteve që do t'i marrim nga kryetarët e degëve, varësisht prej tyre do të bëjmë një riorganizim për betejat e ardhshme politike.

"Epoka e re": Në opinion po flitet për mundësinë e bashkimit të Nismës me ndonjë subjekt tjetër ose edhe shuarjen e saj. Ka gjasa të ndodhë diçka e tillë?

Berisha: Jo, nuk do të ndodhë asnjëra. Me muhalifet e kafeneve nuk merremi. Natyrisht lufta speciale që është zhvilluar para fushatës, e veçanërisht gjatë fushatës, ka sjellë një dobësim, jo shuarje, në asnjë mënyrë.

"Epoka e re": Do ta vazhdoni angazhimin në Nisma nëse kjo e fundit përfundimisht mbetet jashtë Kuvendit?

Berisha: Është apo nuk është pjesë e Kuvendit Nisma, unë edhe më fuqishëm se deri më tani do të angazhohem sepse jam i bindur në përfaqësimin tim politik dhe natyrisht se nuk do të heq dorë në asnjë çast.

"Epoka e re": Z. Berisha, si e shihni qeverinë e ardhshme LV-LDK?

Berisha: Skandaloze, skandaloze! Paraprakisht Albini duhet të tregojë për Isa Mustafën a është argat i Serbisë? Duhet të tregojë se djemtë e Isa Mustafës a vazhdojnë ta kenë biznesin me Serbinë? Po u referohem deklaratave dhe qëndrimeve të tyre. Nëse vazhdojnë të heshtin këta infantilë politikë, e kanë mashtruar qytetarin e

padijshëm, për fatin e keq të Kosovës dhe, thjesht, kanë krijuar një kauzë të rrejshme për të ardhur në pushtet. Kjo do të jetë një kohë shumë e rëndë për Kosovën sepse do të përballet me një situatë tepër delikate, veçanërisht në raport me Serbinë. E dimë se me Serbinë që 20 vjet kemi armëpushim dhe e kemi çështjen e papërfunduar, prandaj këta njerëz të pafy-

tyrë e të pa dinjitet është problem të vendosin në favor të kauzës së vërtetë të qytetarëve të Kosovës. Dëshmitë tashmë janë të shënuara, se brenda ditës tri herë ndryshojnë qëndrimet e lëre më nëse janë në pushtet se çfarë mund të bëjnë.

"Epoka e re": Pavarësisht prej dallimeve dhe të kaluarës së

keqe që kanë pasur këto dy parti, do të mund të bëjë diçka të mirë për vendin koalicioni LV-LDK?

Berisha: Dallimet e mëdha që kanë pasur dhe kanë këto parti lënë të kuptojmë se nuk do të bëjnë diçka të mirë për vendin, nëse arrijnë ta bëjnë qeverinë, natyrisht. Sepse edhe arritja e koalicionit nuk besoj se do të ndodhë.

Universiteti i Prishtinës promovon 14 doktorantë të rinj



KANDIDATËT E SHPALLUR DOKTORANTË JANË:

1. DËFRIM GASHI
2. SKËNDER ZHITIA
3. MUSTAFË HAZIRI
4. VALBONË MEHMETI
5. NESADE MUJA BAJRAKTARI
6. ADIL OLLURI
7. GËZIM QERIMI
8. REXHEP SUMA
9. MURTEZ ZEKOLLI
10. VJOSA FEJZA
11. VLORA PRENAJ
12. SINAN RUSINOVI
13. ZANA VELA GAXHA DHE
14. VALBON AJAZAJ

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Në amfiteatrin e Bibliotekës Qendrore Universitare të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të premtën është mbajtur ceremonia e gradimit të 14 kandidatëve për doktorë të shkencave. Kandidatët e shpallur doktorë të shkencave janë nga Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti Juridik,

Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Mjekësisë.

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema, gjatë kësaj ceremonie i ka uruar doktorantët e rinj, me ç'rast ka theksuar se puna me përkushtim e kandidatëve ka bërë që ata të jenë këtu ku janë sot, duke i bërë krenarë jo vetëm familjarët, por edhe universitetin.

duhet të krijohet si praktikë sepse dëmtohet demokracia në vend. Befasuese është heshtja e klasës politike injorante e Vetëvendosjes ndaj votave të Vuçiqit të cilat kanë helmuar rreth 30 zyrtarë të KQZ-së. Por Vetëvendosje ishte në gjendje të bëjë gjithçka edhe për votat e padrejta dhe të falsifikuara të diasporës të cilat edhe përmes videoincizimeve janë parë se si kanë ardhur. Sidoqoftë, është mirë që pafytyrësia e këtyre po shihet ende pa ardhur në pushtet dhe për fatin e keq të

KPK-ja dhe OPDAT-i vazhdojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, i shoqëruar nga zëvendëskryeprokurorja e Shtetit, Sevdije Morina, ka pritur në takim drejtorin e Zyrës Tejoqeanike për Zhvillimin, Ndhimën dhe Trajnimin e Prokurorisë - OPDAT për Evropën Juglindore, Paul Vaky. Qëllimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi i sistemit prokurorial me OPDAT-in dhe fushat në të cilat duhet të përqendrohen bashkërisht këto institucione në të ardhmen. Me këtë rast, kryesuesi Hyseni dhe zëvendëskryeprokurorja Morina kanë falënderuar drejtorin Vaky për ndihmën e OPDAT-it dhënë sistemit

prokurorial të Kosovës, duke shprehur nevojën e mëtutjeshme për ofrimin e ndihmës në fushën e trajnimeve dhe zhvillimit profesional të prokurorëve kosovarë. Në anën tjetër, lidhur me vazhdimin e mbështetjes për sistemin prokurorial ka folur edhe drejtori Vaky, duke thënë se do të vazhdohet bashkëpunimi për ndihmën e mëtutjeshme në fushat dhe segmentet e nevojshme. Të dy bashkëbiseduesit u fokusuan në tema konkrete të interesit të përbashkët që në të ardhmen pritet të jenë aktivitete në mes të sistemit prokurorial të Kosovës dhe OPDAT-it, me qëllim të ndihmës dhe zhvillimit profesional të prokurorëve të Kosovës.



KEDS-i, pjesë e rëndësishme e konferencës së CIGRE-së



PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Drejtori gjeneral i KEDS-it, Alper Erbas, është nderuar me mirënjohje nga ana e një prej organizatave më prestigjioze në botë të Sistemeve Elektroenergetike, CIGRE. Kjo u bë gjatë fillimit të punimeve të Komitetit të CIGRE Kosova, që po zhvillohet këto ditë në Prishtinë. "Jam krenar që si inxhinier dhe drejtues i KEDS-it jam pjesë e konferencës së parë të CIGRE-s në Kosovë", ka thënë Erbas pas pranimin të mirënjohjes. Konferenca e parë e CIGRE-s në Kosovë ka filluar më 6 nëntor dhe

do të zgjasë deri më 9 nëntor. Pjesë e saj janë edhe kompani prestigjioze botërore, përderisa KEDS-i është sponsor i artë. Drejtori komercial i KESCO-s, Hasan Gokalp Cinbis, ka folur rreth çmimeve të energjisë elektrike dhe punëve që po bën KEDS/KESCO për përshtatjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. "Kosova ka nevojë për më shumë investime të huaja për ta zhvilluar ekonominë dhe për të krijuar vende të reja pune. Çmimet e rregulluara të tarifave statistikisht janë më të lirë në

Evropë dhe pa dyshim çmimet e energjisë elektrike janë parametra shumë të rëndësishëm për investitorët. Mekanizmat tradicionalë duhet të jenë të dizajnuar për përfshirje brenda vetes edhe burimet e ripërtëritshme në atë mënyrë që edhe konsumatorët joshhtëpiakë të mbrohen nga rritjet e paparashikueshme të energjisë elektrike", ka thënë Cinbis. Një prezantim për të arriturat gjashtëvjeçare të KEDS-it prej fillimit të operimeve në Kosovë në emër të kompanisë e ka bërë Iliriana Hajdari.

Hapen edhe dy kurse të gjuhës shqipe në Austri

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Këtë vit shkollor, në rajonin e Salcburgut në Austri, në qytezat Zell am See dhe Maishofen u hapën dy klasa të reja me mësim plotësues në gjuhën shqipe. Kursin e parë e ndjekin 13 nxënës shqiptarë, kurse të dytën 14 veta. Mësuesja Qefsere Demaj thekson se është rritur paksa interesimi i prindërve shqiptarë për dërgimin e fëmijëve të tyre në mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Mësimi plotësues i gjuhës shqipe në Austri organizohet nga shteti austriak, i cili i paguan mësuesit për punën që bëjnë. Mësuesit shqiptarë në Austri janë të kualifikuar dhe organizimi i tyre është



shembull për të mirë në diasporën shqiptare. Shoqata e mësuesve të Austrisë përfshin shumicën e mësuesve

shqiptarë dhe është shoqata më aktive qoftë për organizimin e mësimin brenda shkollës, qoftë për organizimin e aktiviteteve të

lira (mësimi joformal), siç janë organizimi i ekskursioneve në atdhe (Kosovë e Shqipëri), organizimi i kuisseve të dijes, organizi-

mi i vizitave dhe aktiviteteve kulturore e sportive brenda Austrisë dhe aktiviteteve që organizohen për nxënësit mërgimtarë nga MDIS-i.

Me gjithë organizimin e mirë të mësuesve shqiptarë dhe shoqatës së tyre, si dhe mundësi që jep shteti austriak për mësimin e gjuhës amtare, sipas statistikave të institucioneve shtetërore austriake, numri i fëmijëve shqiptarë të moshës shkollare që ndjekin mësimin plotësues është vetëm 19 për qind, që është përqindja më e vogël e përfshirjes në mësimin plotësues të gjuhës amtare nga të gjitha komunitetet e tjera të emigrantëve që jetojnë në Austri.

Klinika e Gastroenterologjisë pajiset me Videogastroskop dhe Videokolonoskop të ri

PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER) - Klinika e Gastroenterologjisë në QKUK është furnizuar me Videogastroskop dhe Videokolonoskop të ri, me të cilat mjekët do të mund t'i trajtojnë pacientët me metoda bashkëkohore. Menaxhmenti Shërbimit Spitalor

dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kishte prioritet furnizimin me aparaturë për këtë klinikë, e cila në vazhdimësi ishte ballafaquar me mungesë të pajisjeve mjekësore. Pajisjet janë të vendosura në një shtyllë dhe mundësojnë incizimin e traktit të sipërm (ezofagut,

lukthit dhe zorrës dymbëdhjetëgjishtore deri në një segment të caktuar). Po ashtu, me këtë aparaturë mjekët mund t'i trajtojnë edhe problemet e shfaqura te trakti i poshtëm digjektiv, që përfshin zorrën e trashë, me mundësi depërtimi deri në 30 centimetra edhe në pjesën përfundimtare të

zorrës së hollë.

Me ardhjen e pajisjeve të reja dhe funksionalizimin e dy dhomave shtesë, në Klinikën e Gastroenterologjisë pritet e pacientëve për trajtim do të shkurtohen, kurse puna për stafin shëndetësor do të jetë më e lehtë.



Shumica e grave deputete siguruan ulëse në Kuvend pa kuotë

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit shumica e grave deputete të ardhshme e Kosovës pa pasur nevojë për kuotë gjinore. Ligji për barazi gjinore në Kosovë obligon që 40 për qind e grave të jenë të përfshira në pozita vendimmarrëse, ndërsa 30 për qind e ligjvënësve kosovarë duhet të jenë të gjinisë femërore. Albert Krasniqi, njohës i zhvillimeve politike në Kosovë, në rrjetin social "Facebook" ka shkruar se në këto zgjedhje do të ketë më së paku gra të zgjedhura në Kuvend me kuotë gjinore, vetëm 13 nga 39 të zgjedhura. Sipas tij, kuotës gjinore gradualisht po i humbet rëndësia. "Është koha të mendohet për kuota gjinore në lista të kandidatëve 50/50", ka shkruar ai.

Të gjitha deputetet e ardhshme (njëmbëdhjetë) të Lëvizjes Vetëvendosje, ka shkruar ai, kanë siguruar ulëset në Kuvendin e Kosovës në bazë të votave të fituara në zgjedhje. Në Lidhjen Demokratike të Kosovës si deputete të ardhshme nëntë kanë hyrë si të zgjedhura, ndërsa dy deputete kanë hyrë përmes kuotës gjinore.

Në Partinë Demokratike të Kosovës tetë deputete kanë siguruar ulëse si të zgjedhura, ndërsa gjashtë kanë hyrë përmes kuotës gjinore. Në koalicionin Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate katër deputete kanë siguruar ulëset si të zgjedhura, ndërsa pesë përmes kuotës gjinore.

Arbëresha Loxha, drejtoreshë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se sigurimi i ulëseve nga shumica e deputeteve të ardhshme pa pasur nevojë për



kuotë gjinore, vë në pah rritjen e fuqisë politike të grave. "Në një mënyrë tregon që në përgjithësi tek opinioni publik, por edhe te votuesit po shihet si avantazh votimi i grave për kontributin që ato mund të sjellin për Parlamentin edhe institucionet dhe jo domosdo vetëm për shkak të kuotës. Mirëpo, konsideroj se kuota gjinore duhet të mbetet për disa arsye, për shkak se Kosova është demokraci e re, nuk është se kemi një nivel të vetëdijes në mesin e partive politike për rolin dhe kontributin që kanë gratë si në reprezentim, brendapërbrenda partive dhe reprezentim të institucioneve", ka thënë Loxha. Eugen Cakolli nga Instituti

Demokratik i Kosovës (KDI) thotë për Radion Evropa e Lirë se ka një trend të rritjes së numrit të deputeteve të cilat fitojnë mandat pa pasur nevojë për kuotë. Megjithatë, ai shton se kuota gjinore, ndonëse në disa aspekte mund të shihet si diskriminuese, duhet të vazhdojë të jetë në përdorim në Kosovë, të paktën edhe për disa palë zgjedhje. "Numri, tashmë, në rritje në baza të trendëve të zgjedhjeve paraprake, i grave që kanë fituar mandat, pa pasur nevojë që këtë mandat ta marrin përmes kuotës, tregon se ekziston një emancipim kulturor dhe qytetar i votuesve të Kosovës, të cilët kanë kaluar barrierat apo stereotipat gjinore që kanë ekzis-

tuar në mesin e shoqërisë sonë. Jemi ende larg shifrës së kënaqshme të përfshirjes së grave në institucione në përgjithësi", ka deklaruar Cakolli.

Edhe Arbëresha Loxha ka shtuar se Kosova ende ka nevojë ta ketë kuotën gjinore në fuqi. Ajo thotë se partive politike vazhdon t'u mungojë vullneti dhe aftësia për të krijuar hapësirë për gra kompetente dhe të talentuara.

Loxha shton se nëse i shikohen strukturat vendimmarrëse të partive pozicionet drejtuese janë pothuajse shumica të paarritshme për shumicën e grave. "Këtë më së miri e tregon edhe pjesëmarrja e grave në listat zgjedhore ku ka qenë vetëm në kuotën e

obligueshme me ligj. Po ashtu, nëse e shohim emërimin minimal në strukturat vendimmarrëse të partive apo në pozita udhëheqëse në qeveri apo institucione publike, gjithë kjo përforcon nevojën që kuota gjinore të mbetet, derisa shoqëria jonë të arrijë një pjekuri që partitë dhe në përgjithësi qytetarët e vlerësojnë fuqinë politike të grave", ka thënë Loxha.

Sistemin e kuotave në Kosovë për herë të parë e pati aplikuar Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 2000. Në bazë të një rregulloreje kërkonte që së paku 30 për qind të kandidatëve në listat e partive të jenë të gjinisë femërore.

Ministri Bytyqi anulon vendimin për mbështetjen e studentëve me bursa



Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shqipri Bytyqi, për shkak të situatës së krijuar pas protestave të studentëve të disa drejtimeve të Universitetit të Prishtinës, në një konferencë të jashtëzakonshme për media të premtën, ka bërë me dije anulimin e vendimit për mbështetjen me bursa studimi për studentët e shkencave teknike dhe shkencave ekzakte. Ministri Bytyqi ka thënë se vendimi për ndarjen e bursave për drejtimet deficitare ka qenë i drejtë dhe është mbi gjendjen aktuale të programeve të këtij konkursi, të cilat janë jo vetëm

deficitare, por edhe rrezikohen të mbyllën. Ai ka treguar se për këtë temë për një vit rresht është diskutuar me Universitetin e Prishtinës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe aktorë të tjerë, ku në fund është themeluar një grup punues i përbashkët i këtyre institucioneve, në mënyrë që të gjendet zgjidhje për të dalë nga kjo situatë.

Ministri Bytyqi ka theksuar se bursat të cilat i ndanë Ministria e Arsimit nuk janë bursa gjithëpërfshirëse, por bursa të mbështetura në aktet ligjore dhe nënligjore për fusha specifike sipas UA nr. 14/2017, neni 3, paragrafi 1.4, ku përcakton qartë që çdo vit Ministria e Arsimit duhet të bëjë një analizë paraprake për t'i përkrahur

programet e caktuara të universiteteve publike. "Shpallja e konkursit është bërë mbi këtë analizë, e cila përfshinë një periudhë gati njëvjeçare dhe nuk është bërë ad-hock siç po thuhet", është shprehur ministri Bytyqi.

Duke shprehur vendosmërinë që vendimi ka qenë plotësisht i drejtë, Bytyqi ka bërë me dije se në rrethanat në të cilat ndodhemi është parë i nevojshëm anulimi i vendimit deri në ardhjen e ministrit të ri të Arsimit. Ministri Bytyqi ka shprehur besimin e tij që këtë vendim ta shtyjë deri në fund ministri i ardhshëm i Arsimit, në mënyrë që buxheti i paraparë për këto bursa të mos kalojë në deficit.

Ekspertët zviceranë hedhin poshtë konstatimet e institucioneve kosovare për rastin 'Astrit Dehari'



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Në bazë të raportit të autopsisë të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë (me numër reference IML: MA16-286, të datës 7 nëntor 2016), "vdekja e Astrit Deharit ka ardhur si pasojë e asfiksionit mekanik nga bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes nga një mjet me konsistencë solide (i fortë) dhe se shkaktimi i vdekjes mund të shpjegohet me ndaljen e menjëhershme të punës së zemrës" (në tekstin e autopsisë: ndaljen "reflektore të punës së zemrës").

Krahas diagnozave, që përkufizohen si shkaktoarë të vdekjes, ekipi mjeko-ligjor që kreu autopsinë në Kosovë interpreton lëndimet që ka pasur Astrit Dehari. Në pjesën e titulluar: "Shkaqet dhe mekanizmi i vdekjes", ky ekip përmend vetëm lëndimet që ishin përshkruar në pikën 1 dhe 2 të raportit të autopsisë dhe i përkufizojnë si dëmtime, që me "besueshmëri janë dëmtime të vetëshkaktuara".

Në pikat 1 dhe 2 të raportit të lartpërmendur të autopsisë përshkruhen vetëm lëndimet në anën e djathtë të qafës dhe në pjesën e poshtme të brendshme të parakrahut të dorës së majtë dhe përkufizohen si "dëmtime (gërvishje) sipërfaqësore të lëkurës".

Duke u mbështetur në këtë raport, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, më 18 nëntor 2016, në një konferencë të jashtëzakonshme, deklaroi: "Nga dëshmitë e siguruar deri më tani nuk është dhënë asnjë dyshim i mundshëm për ndonjë përlëshje fizike apo probleme në mes të paraburgosurve dhe oficerëve me tani të ndjerin Dehari. Nuk është gjetur asnjë provë apo dëshmi e mundshme se ka ndonjë ndërhyrje me faktor të jashtëm që rezultojnë në lëndimin apo dëmtimin fizik të të ndjerit Astrit Dehari. Të gjitha provat dhe ekzaminimet demonstrojnë se ky rast ishte vetëvrasje". Për t'u dukur bindës në punën "profesionale" që kanë bërë, Sylë Hoxha saktëson se "gjatë procesit hetimor janë marrë në pyetje 17 persona, nga të cilët janë rimarrë në pyetje katër prej tyre dhe janë ekzaminuar të gjitha dëshmitë e sekuestruara nga vendi i ngjarjes".

Ekspertët mjeko-ligjorë zviceranë analizuan procesverbalet e hetuesisë, raportin e lartpërmendur të autopsisë, rezultatet e punës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë dhe të dhënat për aspektet fizike, psikologjike dhe sociale, që kanë të

bëjnë me vdekjen e Astrit Deharit.

Në pjesën e mësipërme, që u publikua si pjesa e parë e këtij shkrimi, u përmendën pasaktësi të shumta që përmban raporti i autopsisë së lartpërmendur lidhur me lëndimet që shihen në ekzaminimin e jashtëm, por edhe një numër lëndimesh që nuk përmenden fare në këtë raport. Sa iu përket plagëve sipërfaqësore, për të cilën ekspertët mjeko-ligjorë të Kosovës deklarojnë me "besueshmëri" se "janë dëmtime të vetëshkaktuara", ekspertët zviceranë kanë dyshimet e tyre dhe vijnë në këtë përfundim: "Plagët sipërfaqësore, të vërejtura në pjesën anësore të qafës, në anën e djathtë, si dhe në krcin e majtë, janë pasoja të shkaktoara nga goditjet me një mjet të mprehtë dhe, sipas vendit ku ndodhen, fillimisht mund të mendohet se kemi të bëjmë me lëndime të kryera kundër vetvetes. Duke u nisur nga fakti i karakterit sipërfaqësor i këtyre plagëve dhe nga fakti se z. Astrit Dehari kishte njohuri mjekësore, vërshtirë se mund të besohet që këto lëndime të jenë shkaktoar nga autori, me qëllim që ta shkaktojë vetëvrasjen". Në këtë kontekst, ekspertët zviceranë jo vetëm që nuk përjashtojnë ndërhyrjen e "faktorit të jashtëm" në shkaktimin e lëndimeve të tilla por, përkundrazi, ata mbështesin domosdoshmërinë e ndriçimit të "hipotezës nëse këto lëndime janë shkaktoar nga një person tjetër, me qëllim të maskimit të krimi". Përjashtimi i hipotezës për përfshirjen e personave të tjerë në këtë krim nuk mund të bëhet në mënyrën siç është vepruar, pa asnjë fakt, nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha. Një hipotezë e tillë duhet të përjashtohet vetëm nëse me fakte të pakontestueshme dëshmohej që persona të tjerë nuk kanë qenë të përfshirë në procesin fatal.

Sa i përket mënyrës se si është vepruar gjatë hetuesisë, gjatë autopsisë dhe gjatë punës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me rastin "Astrit Dehari", ekspertët zviceranë bëjnë vërejtje të shumta. Vërejtje thelbësore bëhet rreth pretendimeve të Prokurorisë së Prizrenit, për goja profesionalizmin që kanë treguar "gjatë procesit hetimor, kur janë marrë në pyetje 17 persona".

Duke u mbështetur në materialet që u janë dorëzuar nga autoritetet e Kosovës, ekspertët zviceranë tërheqin vëmendjen në faktin se 12 ditë pas vdekjes së Astrit Deharit, "më 17 nëntor 2016, Njësia Forenzike e Kosovës ka bërë fotografimin e Naser Makollit, të

Frok Berishës dhe të Adonis Gashit, tre të burgosurve që ishin në të njëjtën dhomë me Astrit Deharin. Ata janë fotografuar lakuriqë dhe nuk janë vërejtur lëndime, gjurmë apo shenja që mund të ngjallin dyshime". Lidhur me konstatimet e policisë, se "të burgosurit e lartpërmendur nuk kishin lëndime në datën e fotografimit", ekspertët zviceranë theksojnë: "Megjithatë, duhet të vihet re se ky afat është shumë i gjatë dhe se gjurmët eventuale ose lëndimet ndërkohë kanë mundur të zhduken".

Vërejtja e dytë bëhet lidhur me shenjat e gishtërinjve që janë gjetur në shishen plastike, në një enë për vlimin e ujit dhe një orë dore.

Në bazë të raportit daktiloskopik të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, në shishen plastike, në një enë për vlimin e ujit dhe në orën e Astrit Deharit janë gjetur gjurmë jo të plota të gishtërinjve, të cilat ishin të pamjaftueshme për t'i përdorur në procesin e identifikimit të personave, të cilëve iu përkëtin këto gjurmë.

Shishja plastike ("bouteilleenplastique" në frëngjisht), me të cilën pretendohet se është mbytur Astrit Dehari, përmendet me dhjetëra herë dhe është e përkthyer saktë. Në paragrafin, ku ekspertët zviceranë vënë në pah çështjen e gjurmëve jo të plota të gishtërinjve, "bouteilleenplastique", është përkthyer "kuti prej plastike"! Është e pabesueshme që "bouteilleenplastique" ("shishja plastike"), e përkthyer saktësisht me dhjetëra herë, rastësisht të jetë përkthyer gabimisht, pikërisht në kontekstin kur flitet për gjurmë gishtërinjsh në shishen plastike, që dëshmitarët e kishin parë në gojën e Astrit Deharit. Kam bindjen e plotë se heqja e fjalës "shishë" dhe zëvendësimi i saj me fjalën "kuti" nuk është i rastësishëm. Përkundrazi, kemi të bëjmë me ndryshim të qëllimshëm, për ta fshehur në "kuti" shishen bashkë me gjurmët e saj.

Ndërsa sa i përket faktit, që Agjencia e Kosovës për Forenzikë "nuk ka identifikuar asnjë përzjerje gjurmësh gjenetike gjatë analizave të sendeve të ndryshme dhe të rrobave të Astrit Deharit", ekspertët zviceranë e cilësojnë si "të habitshme", sepse nuk është e besueshme të arrihet tek ato rezultate "në rastet kur kemi katër individë në një dhomë". Prandaj, ata shprehin gatishmërinë e tyre "për analiza gjenetike shtesë".

Vërejtja e mësipërme është një goditje e rëndë për procesin e hetimeve në rastin "Astrit Dehari". Sidomos kur kemi të bëjmë me zbatimin e metodave shkencore për ndriçimin e krimi.

Përkthimi në gjuhën shqipe i kësaj vërejtjeje ia zvogëlon rëndësinë që i japin ekspertët zviceranë. Në vend të "përzjerje gjurmësh gjenetike" ("mélange de tracesgénétiqes" në frëngjisht), që nënkupton përzjerje të dy apo më shumë ADN-ve, analizimi i së cilave mundëson identifikimin e personave që kanë qenë pranë njëri-tjetrit, në tekstin shqip është përkthyer si "përzjerje e gjurmëve digjitale". Nuk besoj të jetë i rastësishëm as përkthimi i kësaj

vërejtjeje, për vetë faktin se paragrafi paraprirë në raportin e ekspertizës zvicerane lidhet pikërisht me gjurmët e gishtërinjve ("Desempreintes digjitales", në frëngjisht). Edhe ata që nuk e njohin gjuhën frënge, mund ta vërejnë se nuk janë të njëjtat gjëra "mélange de tracesgénétiqes" dhe "desempreintes digjitales". Lënia e gjurmëve gjenetike është rezultat i vendosjes së qelizave në një send, gjatë kontaktit të individit me atë send, kurse përzjerja gjenetike është kur me këtë send kanë pasur kontakte edhe individë të tjerë. Për këtë arsye, për ekspertët zviceranë është e habitshme si ka mundur të ndodhë, që në sendet e lartpërmendura të mos ketë gjurmë gjenetike të personave të tjerë, që kanë qenë në të njëjtën dhomë me Astrit Deharin. Një gjë e tillë nuk është e mundur, pos nëse dikush i ka fshirë qëllimisht!

Në raportin shtesë të datës 9 shtator 2019 (me numër reference: EI190001 TF/SG/jb, V/ref. PPN/Inr. 461/16), Njësia Romande e Mjekësisë Forenzike e Qendrës Universitare Romande të Mjekësisë Ligjore në Lozanë trajton analizën gjenetike që është bërë në Kosovë. Ekspertiza zvicerane bën një numër të madh vërejtjesh lidhur me mënyrën se si është vepruar gjatë analizës gjenetike të sendeve "të skenës së krimi".

Vërejtja kryesore bëhet për shkak të faktit, se nuk janë analizuar të gjitha sendet që duhej të analizoheshin e që janë thelbësore për ndriçimin e rastit. Pse u kufizuan analizat gjenetike në Kosovë, kryesisht në sendet që kanë pasur gjurmë gjaku dhe nuk është analizuar trikoja e Astrit Deharit apo fletorja ku Astrit Dehari mbante ditarin e vet, e cila u gjet në dysheme afër krevatit të Naser Makollit? Për çfarë arsyeje ekspertët e Kosovës nuk e saktësojnë vendin nga ku janë marrë mostrat e analizave? Nuk është e parëndësishme të dihet nëse mostra është marrë nga fundi i shishes, që ka qenë e futur në gojën e Astrit Deharit, nga ku rezultati i analizave domosdoshmërisht do të rezultojë pozitivisht me ADN-në e Astrit Deharit, apo në pjesën e sipërme të shishes, ku ka mundur të ketë gjurmë gjenetike të ndonjë personi tjetër...

Për çfarë arsyeje janë hequr një numër mostrash nga lista e mostrave të analizuar në Kosovë? Ku humbi mostra me numër 20 dhe pse u hoq nga lista e mostrave që mbajnë numrat nga 1-21? E njëjta gjë vlen edhe për serinë e mostrave 14.1-14.4, ku mungojnë mostrat 14.2 dhe 14.3, pa u dhënë asnjë shpjegim. Cilat ishin rezultatet e tyre? Kush i hoqi thonjtë e duarve të Astrit Deharit nga zarfet? Edhe nëse pranohet hipoteza, se thonjtë janë shfrytëzuar gjatë analizave të bëra nga Agjencia Kosovare e Forenzikës, prapëseprapë një çështje mbetet e dyshimtë: pse zarfet u dërguan bosh në Zvicër?

Nga mungesat e shumta që e përkthejnë punën e ekspertëve të Kosovës në rastin konkret, ekspertiza zvicerane përmend vetëm një

shembull për ilustrim: "Agjencia e Kosovës për Forenzikë nuk i ka analizuar mostrat që janë marrë nga ora e Astrit Deharit që, sipas tyre, përmbanin shumë pak ADN. Nga mostra që kemi marrë prej të njëjtës ore, ne kemi mundur ta nxjerrim profilin e ADN-së së një burri të panjohur, i emëruar H1. Ky rezultat lë të nënkuptohet se sigurisht mund të nxirren profile të ADN-së edhe nga gjurmët e tjera që nuk janë analizuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Analiza të tilla mund të bëhen edhe nga ADN-ja, që tanimë janë nxjerrë nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ose nga mostrat që ka realizuar Qendra Universitare Romande e Mjekësisë Ligjore në Lozanë, për aq kohë sa ruhet materiali".

Ekspertët zviceranë hedhin poshtë interpretimin e plagëve sipërfaqësore, të shkaktoara nga goditjet me një mjet të mprehtë në pjesën anësore të qafës, në anën e djathtë dhe të kyçit të majtë, si "dëmtime të vetëshkaktuara", që i kanë paraprirë "vetëvrasjes me zënie fryme". Ata theksojnë se në literaturën shkencore, që ka të bëjë me vetëvrasjet, "asnjëherë nuk është përshkruar vetëvrasja komplekse, që implikon një zënie fryme të llojit 'smothering', të cilit t'i ketë paraprirë përdorimi i një objekti të mprehtë".

Duke u mbështetur në analizat e veta, ekipi mjeko-ligjor zviceran erdhi në përfundimet, se "një numër lëndimesh të konstatuara mbi trupin e z. Astrit Dehari nuk janë përshkruar nga mjekët ligjorë të Kosovës, që kanë kryer autopsinë apo edhe nga të tjerë dhe nuk janë marrë parasysh në konkluzionet përfundimtare të raportit të autopsisë:

Lëndimet e shkaktoara me mjete jo të mprehta janë gjetur në nivelin e pjesës anësore të fytyrës, në anën e djathtë, dhe në pjesën anësore të qafës, në anën e djathtë, në parakrahun e djathtë dhe të shuplakës së djathtë, të cilat mund të jenë shkaktoar nga goditjet me mjete të forta, nga shtrëngime të qafës ose nga mbërthime të dorës. Duke pasur parasysh vendin ku ndodhen këto lëndime, ekipi mjeko-ligjor zviceran nuk beson që kanë ndodhur aksidentalisht. Ndërkaq, përpjekjet e ekspertëve të Kosovës i shpjegojnë si lëndime të shkaktoara gjatë bartjes së trupit të Astrit Deharit, veprimeve mjekësore për ta kthyer në jetë apo "konvulsioneve" që shoqërojnë bllokimin e rrugëve të frymëmarrjes, por që nuk duken bindëse. Prandaj, ekspertiza zvicerane nxjerr konkluzionin, se rrethanat e vdekjes së z. Astrit Dehari janë shumë të dyshimta për shkak të ndërhyrjes së një personi tjetër në procesin fatal.

Në cilat fakte mbështet ekipi mjeko-ligjor zviceran për t'i hedhur poshtë diagnozat e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë dhe të kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha? Pse Astrit Dehari nuk ka bërë vetëvrasje? Ku janë kundërthëniet e diagnozave të ekipit mjeko-ligjor të Kosovës dhe të prokurorit Sylë Hoxha? Të gjitha këto çështje do të trajtohen në pjesën që vijon.

BE-ja investon 700 mijë euro për fuqizimin e Zyrës së Auditimit në Kosovë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka mbajtur të premten konferencën për hapjen e projektit të binjakëzimit "Fuqizimi i mëtejshëm i ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë". Projekti financohet nga BE-ja dhe do të zbatohet nga Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë, me mbështetjen e institucioneve supreme të Auditimit të Kroacisë, Çekisë, Letonisë, Lituanisë dhe Portugalisë. Projekti përbëhet nga tre komponentët: komunikimi me qytetarë, parlamentin dhe palët e tjera të interesit. Vlera e projektit kap shumën prej 700 000 eurosh dhe pritet të realizohet brenda 18 muajve.

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka njoftuar se projekti do t'i fuqizojë kapacitetet e institucioneve të ZKA-së si dhe do ta ndihmojë Kosovën drejt rrugës së integritetit në BE. "Projekt i mirë për faktin se ne kemi mundësi të përparojmë dhe ta ndihmojmë Kosovën në rrugën e integriteteve evropiane. Që të bësh bashkë pesë vende të BE-së dhe t'i sjellim bashkërisht me ndihmën e BE-së në Kosovë që të ndihmojë auditorët e Kosovës do të thotë te kemi një ditë të shënimit. Kosova ka krijuar një miqësi. Polonia na ka mundësuar që për herë të parë t'i fuqizojmë kapacitetet e auditorit", ka deklaruar Osmani. Kryetari Suprem i Auditimit në Poloni, Marian Banas, ka thënë se vendet duhet të shkojnë në hap

me ndryshimet. Ai ka thënë se janë duke punuar intensivisht në kontrollimin se sa rekomandimet e BE-së do të zbatohen. "Dëshiroj t'i përgëzoj kolegët kosovarë për anëtarësim në SNISA. Kosova është një vend i vendosur në male andaj e kuptoj mirë jetesën në male dhe nuk është e lehtë pasi duhet të përballesh me natyrën. Lidhja me tokën dhe familjen e tyre janë tipare të malësorëve. Duhet që dijet tona, rekomandimet t'i paraqesim të kontrolluarve parlamentit dhe shoqërisë. Dhe duhet të dimë se si rekomandimet tona zbatohen. Ne duhet të shkojmë në një hap me këto ndryshime. Kontrolli në informatikë është pjesë e këtij projekti. Komunikimi gjatë viteve të fundit ka ndryshuar gjithçka. Informacionet përhapen

vazhdimisht. Jemi të përmbytur nga informacioni i cili mund të jetë edhe i rremë. Organi i shtetit duhet të jetë një informator i saktë", u shpreh ai. Hillen Francke, zëvendëskryesuese e Bashkëpunimit në Zyrën e Bashkimit Evropian, ka deklaruar se ZKA-ja është një nga institucionet më të besueshme në vend. Sipas saj, në ZKA është rritur numri i zyrtarëve për 8 për qind. "Jemi të lumtur me të arriturat deri më tani. Ne si BE ndiejmë që zyra është zotuar dhe përkushtuar në forcimin e kapaciteteve kemi pasur shumë ndryshime. Është rritur numri i zyrave nga 4-8 për qind të auditimit. Mbi 1 000 rekomandime për auditim. Një nga institucionet më të besueshme në Kosovë dhe është për t'u përgëzuar. Komunitat kanë

për të bërë mjaft për t'u përmirësuar", u shpreh Francke, duke shtuar se ky projekt do të ndihmojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. "Përfshirja në dëgjimet publike të financave nuk ndodhë e ky është problem. Organizatat që i zbatojnë mund të ndihen të pamotivuar dhe për këtë arsye duhet të mbikëqyren. Auditimet e performancës janë të rëndësishme. Ato paraqesin një vlerësim të pavarur të politikave qeveritare. Gjetjet mund ta ndryshojnë jetën e qytetarëve. Cilësia e ajrit është problem i madh në Kosovë, lista e barnave esenciale, si dhe shqyrtimi i politikave të papunësisë. Menaxhimi i granteve të bujqësisë. Ky projekt do të ndihmojë në përmirësimin e institucioneve dhe Zyrës së Auditimit", u shpreh ajo.



Punëtorët e 'Infrakos'-it kërkohjnë pagat e tyre

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Punëtorët e "Infrakos"-it të premten kanë mbajtur një protestë njëorëshe prej orës 08:00 deri në orën 09:00, pasi që ka vonesa në marrjen e pagës së muajit shtator dhe tetor. Krahas pagave të këtyre dy muajve, punëtorët e kësaj kompanie hekurudhore kanë kërkuar edhe shlyerjen e borxhit të Trustit Pensional. Kryetari i Sindikatës së Pavarur "Infrakos", Hysen Nikqi, ka thënë se nëpërmjet kësaj proteste njëorëshe po e shprehin revoltën karshi menaxhmentit i cili nuk po i plotëson kërkesat e këtyre punëtorëve. Përpos pagës dhe trustit, ai ka thënë se kërkohet që punëtorët e shërbimit ekzekutiv të pajisen me uniforma dhe rroba mbrojtëse si dhe të bëhet pagesa e borxheve të anëtarësisë së Sindikatës për muajt e

kaluar të vitit 2019. Nikqi ka thënë se situata po vështirësohet pasi për gjendjen e krijuar askush nuk po merr përgjegjësi dhe se kërkesat e tyre ndër vite kanë hasur në vesh të shurdhër. Ai ka shtuar se për kërkesat e punëtorëve menaxhmenti është i njoftuar tash e dy javë dhe se nëse nuk ndërmarrin asnjë veprim do ta vazhdojnë grevën e përgjithshme. "Fatkeqësisht, nuk është realizuar asnjë, prandaj për këtë është mbledhur e gjitha masa e punëtorëve këtu. Si arsyetim e japin se nuk ka mjete, ndërsa luksi i menaxhmentit nuk ndalet kurrë me dreka, darka dhe makina. Sot është paralizuar qarkullimi i trenave në gjithë territorin e Kosovës. E njëjta do të ndodhë edhe të hënën dhe do të na dërgojnë deri në grevën absolute të gjithë punëtorëve",



ka thënë kryesindikalisti. Fadil Orllati, mbikëqyrës i binarëve në "Infrakos", ka pohuar se që tre muaj gati janë pa paga dhe mezi po ia dalin t'i kryejnë obligimet edhe ndaj bankave. Edhe Shaip Nuredini ka kritika

ndaj menaxhmentit të "Infrakos"-it. Sipas tij, menaxhmenti nuk po jep asnjë arsytim për këto vonesa të pagave të tyre. Nuredini ka ankesa edhe për kushtet e punës. Punëtorët e "Infrakos"-it do të protestojnë edhe të hënën nga

ora 8:00 deri në orën 10:00, për të vazhduar edhe të martën nga ora 8:00 deri në ora 12:00. Punëtorët e "Infrakos"-it kanë protestuar edhe në pranverën e këtij viti për shkak të vonesave të pagave të tyre.

Të rinjtë vitias aftësohen për tregun e punës

VITI, 8 NËNTOR (ER) - Në kuadër të projektit "Your Job" i cili financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe që implementohet nga Caritas Kosova në Viti është duke u zhvilluar trajnimi dyditor që ka për qëllim përgatitjen e të rinjve për tregun e punës dhe orientimin e tyre në

karrierë.

Dorentina Ismajli, përfaqësuese e Caritas Kosova në Viti, ka bërë me dije se ky trajnim ka filluar të enjten me aftësimin e të rinjve se si të përgatiten ata për intervista të punës, teknikat e komunikimit, shkrimit të CV-së dhe letrës motivuese. Ndërsa në ditën e

dytë që është mbajtur të premtën të rinjtë vitias kanë mësuar mbi testin për karrierë, tipat e personaliteteve, zhvillimin në karrierë dhe ndërmarrësi dhe praktikën dhe ushtrime të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me përgatitjet për tregun e punës.



Komuna e Rahovecit nis rregullimin e shtretërve të lumenjve

RAHOVEC, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se të premtën ka nisur projekti për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve në këtë komunë. "Me qëllim të parandalimit të ndotjes së lumenjve, e cila ndot në masë të madhe mjedisin, parandalimit të vërshimeve dhe rehabilitimin e atyre pjesëve që janë të nevojshme, sot, në Ditën Botërore të Planifikimit Hapësinor filluam në Nagac projektin 'Rregullimi i shtretërve të lumenjve nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac deri në Krushë të Madhe', LOT 2, me vlerën: 555 535 87 euro, i cili përfshin vendbanimet Hoçë e Vogël,

Nagac dhe Krushë e Madhe", ka thënë Latifi.

Më tutje, Latifi ka theksuar se projekti në fjalë është investim i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe implementohet nga Komuna e Rahovecit. "Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza, ndërtimi i urave, ndriçimi dhe stazat për ecje janë disa nga elementet që do ta përcjellin këtë projekt, i cili do të ketë dobi të shumta për banorët e kësaj zone. Duke e ditur që shkaktari kryesor i ndotjes së lumenjve është faktori njeri, lus që ta ruajmë duke shmangur të gjitha elementet që mund të çojnë në shkatërrim të kësaj që sot po fillojmë ta ndërtojmë", ka deklaruar Latifi.



Nisi ndërtimi i tualeteve publike në 'Parkun e Lirisë' në Ferizaj



FERIZAJ, 8 NËNTOR (ER) - "Parku i lirisë", pas investimeve të kryera pak javë më parë nga qeverisja lokale për ta rregulluar këndin e lojërave, ndriçimin dhe infrastrukturën përcjellës, po kompletohet edhe me nyjat e domosdoshme higjienike. Bëhet fjalë për projektin e ndërtimit të tualeteve publike në hapësirën e këtij parku, projekt ky që po zhvillohet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Komuna e Ferizajt ka njoftuar e me këtë investim përfundohet cikli i investimeve bazike infrastrukturore në këtë park. "Me këtë investim përfundohet cikli i investimeve bazike infra-

strukturore, duke shtuar se edhe rruga që çon në këtë aset natyror me vlerë të jashtëzakonshme për ferizajasit, shumë shpejt do të përfundohet, çka përfundimisht krijohet një hapësirë e përshtatshme, lehtë e qasshme dhe rekreative për frekuentuesit e kësaj zone. Madje qeverisja lokale e udhëhequr nga kryetari Aliu ka plan të veçantë investiv e masash që do të ndërmerren për maksimizimin e shfrytëzimit të kësaj hapësire, që do ta kthejë këtë zonë në një nga zonat më të bukura e funksionale në gjithë territorin e Ferizajt e më gjerë", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.

Jashari përcjell nga afër realizimin e projekteve në dy fshatra të Skenderajt

SKENDERAJ, 8 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, drejtoreshën e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, inxhinierë dhe profesionistë, kanë inspektuar punimet për realizimin e projekteve në rrugët e fshatit Kotorr dhe

projektin e rrugës Runik - Syriganë. Me këtë rast, Jashari ka thënë se këto projekte janë shumë të rëndësishme për banorët e këtyre fshatrave. "Së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe bashkëpunëtorë, pamë nga afër punimet që po zhvillohen në rrugët e fshatit Kotorr dhe

projektin e rrugës nga qendra e Runikut deri në Syriganë. Një projekt mjaft i rëndësishëm për banorët e kësaj pjese, ku gjithashtu përfshihet edhe asfaltimi i shumë kilometrave të tjerë të segmenteve nëpër fshatrat e kësaj ane", ka thënë Jashari.



USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE HAGA



Shkruan: Ismail SYLA

Dalëngadalë ftesat e Prokurorisë Speciale për "krimet" e luftës në Kosovë po e rrumbullakojnë "grishjen" dhe po arrijnë edhe te krerët më të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që njëkohësisht patën fatin të jenë edhe në krye të institucioneve më të larta shtetërore të shtetit më të ri në Evropë.

Para kësaj Prokurorie u shfaqën (folën dhe heshtën) anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, komandantë të zonave, kryeministri Haradinaj, e dje u bë e ditur botërisht edhe ftesa për kryeparlamentarin Kadri Veseli, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës. Këto ftesa dhe klima që po shkaktojnë ato bëhen në një distancë kohore prej dy dekadash nga mbarimi i luftës në Kosovë. Për arsyet dhe aktorët faktikë që qëndrojnë prapa këtij qëndrimi armiqësor ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare do të flas koha, nga distanca historike, kur prapaska del në skenë. Ato nuk janë synim i këtij shkrimi. Në fakt shkrimi shpreh një opinion dhe një bindje tepër personale.

Prej themelimit të Dhomave të Specializuara (Gjykata e Hagës për Kosovë) e deri më tash kanë kaluar mbi katër vjet dhe në ndërkohë ka lëvizje përmbajtjesore në skenën politike të Kosovës. Deri dje, në krye të institucioneve kyçe të shtetit të Kosovës ishin figura të larta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ramush Haradinaj, kryeministër dhe Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Hashim Thaçi vazhdon të jetë President i Republikës së Kosovës në bazë të mandatit (2016 - 2021).

Zgjedhjet e 6 tetorit 2019 kanë bërë një zhvendosje interesante. Dy liderët e dy institucioneve kryesore, Ramush Haradinaj dhe Kadri Veseli nga të qenit në pozitë, zgjedhjet i flakën në opozitë me rezultat të qartë, si parti e tretë (PDK), gjegjësisht e katërt (AAK). Sot, kur ftesat po e arrijnë rrumbullakimin këta dy liderë i gjen në opozitë. E, po ashtu, në opozitë, pa përfaqësim në parlament, gjendet edhe një figurë e fuqishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fatmir Limaj.

Kjo do të thotë se njerëzit më të fuqishëm politikë me prejardhje nga platforma politike dhe ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që i patën në duar institucionet qendrore të shtetit, u zhvendosën në opozitë, duke mos arritur ta rrumbullakojnë shtetësinë e plotë të Kosovës, marrëveshjen me Serbinë, neutralizimin e Gjykatës Speciale për Kosovë me seli të dyfishtë (Hagë - Prishtinë), arritjen e liberalizimit të vizave dhe fillimin e proceseve të integritetit euroatlantike.

Kjo do të thotë se klima e ftesave dhe çdo gjëje tjetër që do të pasojë, do të zhvillohen në një kohë kur pozicioni institucional i këtyre liderëve ka bazën më të dobët të mbështetjes elektorale. Sa është punuar me sistem dhe durim stoik për rrënimin e autoritetit të kësaj klase politike është çështje më vete. Në këtë politikë rrënuese të autoritetit politik dhe publik të figurave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka armiq organikë dhe historikë që asnjëherë dhe asnjëherë nuk ua falin kokën (Serbia me të gjitha segmentet aktive) kundërshtarët të brendshëm në nivel nacional dhe "armiq" brenda llojit.

Nëse tek faktori i parë (Serbia) nuk mund të ndikohet, dhe vetëm ndonjë e ardhme arrin ta zbus armiqësinë midis dy shteteve, dy faktorët tjerë, kundërshtarët e brendshëm dhe "armiqtë" brenda llojit, është mirë ta shohin njëri tjetrin në sy ose në pasqyrë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës me të drejtë dhe pakontestueshëm konsiderohet projekti politik dhe ushtarak më serioz i luftës për çlirimin e Kosovës. Në të gjitha periudhat historike shqiptarët e Kosovës kanë luftuar, kanë bërë kryengritje, rebelime dhe protesta, janë organizuar kundër sundimit jugosllav, por kurorëzimin e gjithë atyre synimeve e ka realizuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Pavarësisht kapaciteteve materiale dhe ushtarake, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë shprehja më autentike e qenies kombëtare të shqiptarëve të Kosovës: ajo u mbështet nga populli, zhvilloi qëndresë në terrioret brenda Kosovës, arriti ta ngrit në pikën më lartë angazhimin ndërkombëtar, ku dhe përfundimisht u arrit shkëputja e Kosovës nga administrimi i Serbisë. Kjo nuk nënkupton nënvlerësimin e asnjë përpjekjeje tjetër për çlirimin e Kosovës, por asnjë faktorë brenda kombëtar nuk mund ta injorojë rolin parësor të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës në finalizimin e qëllimit - çlirimin e Kosovës nga Serbia në qershor të vitit 1999.

Lidershipi i UÇK-së i konvertuar në lidhshmëri politik doli i fuqishëm pas mbarimit të luftës më 1999. Filozofia e luftës çlirimtare, duke qenë e tillë natyrisht se në përbërësin e saj ka dy dimensione të pa përjashtueshme: humanizmin dhe popullaritetin. Këto dy produkte të saj u shpërfaqën për së mbari në epokën e lirisë. Liderët e saj u shndërruan në politikanë normalë dhe popullaritetin e bartën tek vlerat e demokracisë. Këto dy vlera normale në skenën e përgjithshme politike të Kosovës bënë që me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, asaj që ndihmoi në arritjen e çlirimit të Kosovës, Kosova të jetë një demokraci normale dhe të bëhet shtet i pavarur.

Lidershipi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në historinë 20 vjeçare të Kosovës në planin e përgjithshëm ka luajtur rol konstruktiv dhe si i tillë është vlerë klasike e demokracisë së Kosovës. Pavarësisht mos përsosurisë, Kosova është shoqëri dhe shtet normal. Ka mijëra shembuj mbi të cilët mund të mbështetemi. P. sh., kultura e njohjes së rezultatit zgjedhor është njëri nga ta. Se lidhshmëria dhe klasa politike e dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka një normalitet dhe vlera të gjithë pranueshme dëshmon edhe praktika e krijimit dhe funksionimit të koalicioneve qeverisëse pas luftës e këndej.

Në arenën politike të Kosovës është krejt normale beteja dhe lufta e forcave politike, që kanë formim, histori dhe etablim të ndryshëm. Po ashtu, është e drejtë e çdo grupimi politik por edhe diçka e pakontrollueshme se çfarë qëndrimi mbajnë ndaj këtij ose atij fenomeni politik, ndaj kësaj ose asaj organizate politike a ushtarake. Prandaj kurrë nuk ka vlerësim uniform ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe liderëve të saj.

Ka një tendencë të përhershme, brenda kombëtare dhe të qarqeve ndërkombëtare që merren me Kosovën, për kuptimin gjeneral të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për drejtuesit individualë të saj. Edhe brenda edhe jashtë ka një konstatim "dashamirës" se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është e mirë. E kur vjen fjala te individët, tek liderët ose drejtuesit e saj ndryshon hesapi. Liderët, komandantët, drejtuesit e saj mund të kontestohen, kontestohen, madje kontestohen plotësisht. Kjo kontestueshmëri totale, tundamendje e plotë, është tendencë që ka vepruar dhe

vepron pa ndalur, pa reshtur, me durim stoik dhe përhershmëri legjendare, njësoj si pika e ujit që dalëngadalë e shpon edhe gurin.

Sistemi i dërgimit të ftesave nga Prokuroria e Hagës, nga poshtë lart përfshin gjithë shtresën e drejtuesve kryesorë të UÇK-së. Kjo i bie që Ushtria Çlirimtare Kosovës ka dy kategori në përbërësin e saj: ushtarë të rëndomtë, luftëtarë liricë, dhe komandues, drejtues të dyshimtë për këtë ose atë vepër, për këtë ose atë krim.

Ndërkaq, në planin e luftës brenda llojit, kemi shembullin më praktik dhe domethënës të koalicionit PAN, që si fillesë tregon domosdoshmërinë dhe nevojën e të qenit bashkë të formacioneve politike me prejardhje nga UÇK-ja dhe fundin grotesk, me kundërvënien joparimore ndaj njëri tjetrit. PAN-i tregoi mungesën e vizionit, si strategji politike dhe të sinqeritetit, si vlerë etike. Ata edhe qenë edhe nuk qenë bashkë në fushatën zgjedhore të 2017. Po të ishin plotësisht bashkë do të prodhonin mbi dyzet deputetë. Ato zgjedhje, sado në zgrip, bënë që në krye të shtetit të ishin dy liderë të UÇK-së. Mos sinqeriteti dhe mungesa e vizionit bënë që të prishet koalicioni dhe të shkohet në zgjedhje të jashtëzakonshme (6 tetor 2019). Ky vullnet dhe kjo dëshirë për të shkuar në zgjedhje u shpërblye me kalim në opozitë. Do të thotë dalje nga zyrat e dy nga institucioneve qendrore të shtetit të Kosovës.

Listimi i shembujve të pakufishëm të luftës brenda llojit nga njerëzit me prejardhje politike nga UÇK-ja do të merrte shumë vend. Kjo luftë është aq e ulët sa nuk ia vlen të shfletohet. Mjafton të kujtohen rastet e thumbimeve, nënvlerësimeve, etiketimeve dhe fyerjeve në fushatën e 2019-ës. Kur brenda llojit ka urrejtje dhe armiqësi, pse të çuditemi nga sulmet që vijnë nga subjektet rivale, nga sulmet që vijnë prej segmenteve armiqësore serbe. Ky mos durim sikur ta kujton kohën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, kur krerët shqiptarë, individualistë dhe krenarë, që kishin shërbyer në perandorinë osmane, krijonin përshtypjen se jo vetëm nuk mund ta duronin shqiptarin mbi kryet e tyre, por as dhe hijen e vetvetes.

Ftesat e fundit nga Specialja e Hagës po vijnë në një kohë të ndërmjetme, midis pushtetit të shkuar të PAN-t dhe atij në ardhje, i mundshëm midis LVV dhe LDK. Po vijnë në kohën kur janë në opozitë PDK-ja, e cila me

deputetët e saj (shumica) e mbështeti krijimin e Gjykatës speciale sa qenë pozitë. Krijimi i kësaj gjykate preku edhe Kushtetutën e Kosovës. Në këtë gjendje dhe atë që po vjen si do të trajtohen njerëzit e UÇK-së nga Gjykata e Hagës dhe cili do të jetë roli i shtetit të Kosovës, në të cilin partitë politike të dala nga UÇK-ja janë komplet në opozitë?

Mbetet të shihet.

E që shihet plotësisht është fakti që ndaj krerëve të UÇK-së po ndodh një padrejtësi historike. Gjykata e Hagës, në këtë rast bashkësia ndërkombëtare, arriti t'i dënojë krerët e shteti të Serbisë për krime lufte, por jo dhe të shpallë fajësimin e shtetit të Serbisë për gjenocid në ish-Jugosllavi (Bosnjë, Kroaci, Kosovë). Gjykata e Hagës sot po synon që t'i barazojë fajtorët: njëjtë drejtuesit e shtetit të Serbisë 1990 - 1999 dhe drejtuesit e UÇK-së 1998 - 1999.

Se nuk mund të barazohen këto gjëra ka me mijëra e mijëra fakte, por le të shërbejë për këtë shkrim konstatimi i publicistit dhe analistit ushtarak James Pettifer, i cili në librin "Ekspresit i Kosovës" krahason përmasat e shtetit serb dhe UÇK-së.

Derisa e Serbia demonstroi luftë ekspansioniste në Slloveni dhe Kroaci, gjenocid në Bosnje dhe në Kosovë përmes një armate të organizuar, me arsenal të plotë ushtarak, me doktrinë dhe planifikim të mirëfilltë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sipas Pettifer kishte tri elemente: automatikun kallashnikov, telefonin Nokia dhe çorganizimin. Në një zberthim simbolik, automatiku është vullneti popullor dhe guximi qytetar i Kosovës, telefoni Nokia është lidhja satelitore dhe mediale me botën e çështjes së Kosovës e cila më nuk mund të përfaqësohet nga imazhi që e krijonte Beogradi dhe, mbajeni mend: - çorganizimi, pra një ushtri e re, e krijuar nga një popull pa shtet.


Dhe krejt në fund: Jam më se i sigurt se njëri nga drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, do të ketë forcën morale, politike dhe kombëtare të qëndrojë stoik përballë kësaj sfide. I vetëdijshëm për vlerat e larta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkundër goditjeve, përbaltjeve, akuzave të rrejshme, shpifjeve dhe klimës kundër UÇK-së, Kadri Veseli dhe gjithë drejtuesit e saj do ta kalojnë këtë provë.

Margaritari, thuhet, mund të mbulohej me baltë, por mbetet margaritar.

E jashtëzakonshme

Gjenden skelete mamutësh, njerëzit i gjuanin me kurthe

Arkeologët zbuluan 14 skelete mamutësh në Meksikë të zënë në gracka të ndërtuara nga njeriu rreth 15.000 vite më parë. Dy gropat e mëdha në Tultepec në veri të Meksikës janë kurthet e para të zbuluara. Të gjitha këto zbulime mund ta hedhin dritë për mënyrën se si njerëzit i gjuanin këto kafshë të mëdha.



Deri më tani dimë se njerëzit i vrisnin mamutët vetëm kur ata ishin plagosur ose kishin rënë në ndonjë kurth.

FOTO E DITES



Një njeri kalon përmes një rruge të përmytur pas shiut të rrëmbyeshëm në Sheffield, Angli. Fotografia është realizuar nga Danny Lawson/PA, e publikuar tek The Guardian./BS/

E rrallë

I humbur prej ditësh, gjendet dora e turistit brenda një peshkaqeni

Një turist scocez dyshohet se ka vdekur pasi gjeti dorën e tij në stomakun e një peshkaqeni. Ai rezultoi i humbur që prej fundjavës dhe herën e fundit që është parë ka qenë duke bërë zhytje në det afër Madagaskarit. 44-vjeçari ishte



me pushime me bashkëshorten e tij. Dora është identifikuar nga unaza që kishte në gisht. Këtë e ka vërtetuar edhe bashkëshortja e tij.

BARSOLETA E DITËS



Beno pse ja ke vu emrin edhe vajzës si të gruas? Kur ja pret ky shoku:
- Mira, o Mira ..ma sill një birra..
Kur për pak sekonda vijnë dy birra.
Ja pra mik, e kuptove??!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00
ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton




Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Keni aftësinë të dëgjoni njëherë përpara se të gjykoni. Do të jetë mjaft e thjeshtë që më pas të arrini në përfundime rreth një projekti.



DEMI

Do ta bëni të pamundurën për të qenë sa më praktik sot. Nuk keni mjaft kohë në dispozicion për një situatë të caktuar.



BINJAKËT

Çdo gjë është në harmoni të plotë sot dhe gjendja juaj shpirtërore do ta përçojë këtë ndjenjë energjie pozitive që ju karakterizon.



GAFORRJA

Sot do të kaloni disa orë tensioni dhe nervozizmi në çift. Përpiquni t'i ulni tensionet sepse mund të përfundojë në një debat të ndezur.



LUANI

Jeni euforik dhe plot ide të reja sot që do t'i ndani me këdo takoni në ditën tuaj. Mbani sytë hapur te njohjet e reja sepse jeni duke takuar personin e zemrës.



VIRGJËRESHA

Disa impenjime të mërzitshme të ditës sot nuk po ju pëlqejnë aspak. Do të nxirrni një pretekst për t'u larguar nga një vend i caktuar.



PESHORJA

Me pak intuitë do të merrni çdo impuls që ju vjen nga ambienti rreth jush për ta kthyer në një projekt mjaft fitimprurës.



AKREPI

Do të përfshihen nga emocione shumë të forta që mund t'ju tërheqin në një drejtim të gabuar. Nuk do ta kuptoni këtë gjë në fillim.



SHIGJETARI

Sot nuk mund të jeni diplomat në ato që thoni për shkak të acarimit që ju shkakton një person i caktuar. Nuk do të njihni limite etike.



BRICJAPI

Nuk keni pse fshihen pas frikës suaj, por duhet t'i bëni ballë një situatë që e keni krijuar po ju. Kërkohet një zgjidhje sa më parë.



UJORI

Sot po shikoni me pozitivitet çdo gjë. Kjo sjellje do të tërheqë në orbitën tuaj njerëz interesantë.



PESHQIT

Doni të dëgjoni atë zërin e brendshëm që ju thotë t'i merrni parasysh pasionet dhe dëshirat tuaja. Por, disa sakrificat konstante, për hir të familjes, nuk ju lënë të qetë.

Kaia Gerber mban shkronjën "P" në qafë, tri ditë pas darkës me Pete Davidson



Modeluesja Kaia Gerber para tri ditësh ishte parë në një darkë në Malibu me aktorin Pete Davidson. Kaia të mërkurën pati një paraqitje në tepihun e kuq të drekës vjetore të Women's Guild Cedars-Sinai Annual Luncheon në

Beverly Hills. Modeluesja pati në qafë një zinxhirë me shkronjën "P". Kjo shkronjë është e njëjtë me atë të Pete Davidsonit. Por, se a janë në lidhje të dashurisë Kaia dhe Pete nuk dihet akoma pasi nuk e kanë komentuar këtë asnjëri.

Kesha lanson markën "Kesha Rose Beauty"



Këngëtarja e njohur Kesha Rose më 3 dhjetor do ta lansojë linjën e parë të produkteve të grimit "Kesha Rose Beauty". Kjo markë e këngëtares përmban një paletë të grimit për sy,

një buzëkuq dhe një produkt për vijën e syrit. "Ndonjëherë me bukurinë ndihet sikur qëllimi është perfeksion. Me linjën time ky nuk është qëllimi. Qëllimi im është lumturia", ka thënë Kesha.



Sëmuret Lady Gaga, anulon performancën në Las Vegas

Lady Gaga ka anuluar performancën në Las Vegas për shkak të bronkitit. Në një postim në rrjetin social "Twitter" ajo ka kërkuar falje për anulimin e kësaj performace pasi ndihej e dobët fizikisht. "Me keqardhjen e saj me të Lady

Gaga njofton anulimin e performancës së sotme në Park MGM sepse është sëmurë nga një infeksion i sinusit dhe bronkitit", ka shkruar Park MGM. Ndërkohë këngëtarja ka publikuar një fotografi në të cilën dukej e sëmurë.

Camile Guaty bëhet nënë



Camile Guaty është bërë nënë zyrtarisht. Aktorja e "The Prison Break" dhe bashkëshorti i saj, Sy Rhys Kaye, janë bërë prindër për herë të parë të djalit të tyre, Morrison Rafael Kaye. Aktorja

i ka vendosur emrin Rafael djalit për nder të babait të saj, ndërsa burri i saj i ka vendosur emrin e gjyshit të tij, Morrison. "People" shkruan se çifti ka dashur t'i vendosë si emër të parë djalit emrin Sonny.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Llapi kërkon fitoren e dytë ndaj Prishtinës

IPKO Superliga sot (e shtunë) sjell dy ndeshje derbi. Në Podujevë Llapi e pret Prishtinën, kurse në Drenas takohen Feronikeli dhe Drita. "Jemi përgatitur sepse e dimë se kemi të bëjmë me një skuadër të fuqishme dhe shumë serioze. Ajo ka super lojtarë dhe përvojë të madhe, por ne e kemi marrë si çdo ndeshje tjetër dhe do ta japim maksimumin në terren. Lojtarët janë shumë të motivuar për këtë ndeshje dhe do ta japim maksimumin për ta arritur synimin", ka thënë Batatina

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Skuadra e Llapit në ndeshjen e parë të këtij edicioni e mposhti Prishtinën (0-1) në sfidën që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri". Të njëjtën gjë skuadra e Tahir Batatinës synon ta bëjë edhe në ndeshjen kthyesë, e cila zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë dhe që është e vlefshme për xhiron e pesëmbëdhjetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

Trajneri Batatina për "Epokën e re" e ka vlerësuar të vështirë përballjen me skuadrën "bardhekaltër" për faktin se në radhët e veta ka shumë lojtarë cilësorë. "Jemi përgatitur sepse e dimë se kemi të bëjmë me një skuadër të fuqishme dhe shumë serioze. Ajo ka super lojtarë dhe përvojë të madhe, por ne e kemi marrë si çdo ndeshje tjetër dhe do ta japim maksimumin në terren. Lojtarët janë shumë të motivuar për këtë ndeshje dhe do ta japim maksimumin për ta arritur synimin", ka thënë Batatina.

Ndërsa futbollistët e skuadrës kryeqytetase nuk kanë qenë të gatshëm të flasim për ndeshjen derbi ndaj Llapit, kurse klubi me anë të një shkrimi në faqen zyrtare ka pyetur se a do të jetë skuadra e gatshme të këndellet pas dy ndeshjeve pa fitore në elitë. "A mund të këndellet Prishtina që në ndeshjen me Llapin? 'Bardhekaltrit' janë dy ndeshje pa fituar dhe tani i pret tjetër ndeshje e vështirë, në Podujevë te rivalët e Llapit. Se a mundet Prishtina ta fillojë këndelljen nga kjo përballje, mbetet të shihet në ndeshjen e së shtunës. Por, çdo ekip i madh, kur nuk i mungon cilësia, e merr veten pikërisht nga përballjet e vështira.



Përndryshe, dy skuadrat ndajnë pozitën 4 dhe 5 me nga 24 pikë të tubuara, ndërsa skuadra llapjane pati fituar ndeshjen e parë të këtij edicioni duke triumfuar për herë të parë në histori të klubit në "Fadil Vokrri", thuhet në shkrimin e skuadrës së Prishtinës, e cila përballjen e fundit si vendëse e humbi nga Feronikeli me rezultat 2-3, kurse paraprakisht luajti me Dukagjinin me rezultat 0-0.

Krahas kësaj ndeshje, sot (e shtunë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër derbi, ku kampioni në fuqi, Feronikeli, e pret skuadrën e Dritës. "Nikli" në ndeshjen e fundit fitoi në Prishtinë dhe motivi është rritur për t'i ndjekur skuadrat e para në renditjen tabelore, kurse Drita në mesjavë mezi e mposhti Dukagjinin e Klinës (1-0) dhe synim e ka të marrë një rezultat pozitiv në Drenas.

Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen nesër (e diel) dhe java e pesëmbëdhjetë mbyllet të hënën me dy përballjet e fundit.

IPKO SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
13:00 Llapi - Prishtina
13:00 Feronikeli - Drita

Të dielën takohen:
13:00 Trepça '89 - Ballkani
13:00 Gjilani - Drenica

Të hënën takohen:
13:00 Vushtrria - Ferizaj
13:00 Dukagjini - Flamurtari

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
Ramiz Sadiku - Vllaznia

Të dielën takohen:
Onix - Dardana
Drenasi - Vitia
Trepça - Vëllaznimi
Liria - Istogu
Ulpiana - Arbëria
2 Korriku - KEK-u
Besa - Malisheva

SHKURT

McFolley përforcon Rahovecin

KB Rahoveci ka njoftuar se është përforcuar me një lojtar të ri amerikan. Fjala është për fundorin 22-vjeçar Joshua McFolley. "Ai ishte pjesë e disa skuadrave në Detroit të ShBA-së, ndërsa në edicionin e fundit, prej 31 ndeshjeve, ka startuar me 27 prej tyre, duke shënuar 13.5 pikë për ndeshje. McFolley ka arritur në Rahovec për t'iu bashkuar skuadrës sonë që është në top formë në Superligë", thuhet në njoftim e "vreshtarëve".

Xhaka pas Milanit, kërkohet edhe nga Newcastle

Granit Xhaka është gjithnjë e me larg skuadrës së Arsenalit, pasi klubi anglez po e shqyrton shitjen e tij në afatin kalimtar të janarit. 27-vjeçari nga Kosova, pas përplasjes me tifozët e Arsenalit, është lënë jashtë skuadrës për disa ndeshje, kurse atij i është hequr edhe shiriti i kapitenit. Pas Milanit dhe disa klubeve nga Gjermania interesim për lojtarin shqiptar ka treguar edhe skuadra e Newcastle Unitedit.

Sot fillon kursi ASMC 2

Pas përfundimit me sukses të kursit për Menaxhimin e Avancuar Sportiv ASMC 1, Komiteti Olimpik i Kosovës do të nisë organizimin e ASMC 2. Ligjërues të përhershëm të kursit janë: Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, Ibër Alaj, drejtor i Departamentit të Sportit në MKRS, MEMOS 19 dhe Elda Gjoka, drejtoreshë kombëtare për organizimin e kurseve bazike për administratorë të sportit, MEMOS 9. Krahas tyre pritet të ketë edhe ligjërues ndërkombëtarë. Kursin do ta vijojnë presidentë, sekretarë të përgjithshëm dhe përfaqësues të lartë të federatave sportive në Kosovë. Kursi ka gjashtë module dhe pritet të përfundojë në mesin e vitit 2020.

Lista e Kosovës për ndeshjet kundër Çekisë dhe Anglisë

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Bernard Challandes, e ka publikuar listën e futbollistëve për dy ndeshjet e fundit në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020", kundër Republikës së Çekisë, më 14 nëntor në stadiumin "Doosan Arena" në Plzen dhe

kundër Anglisë, më 17 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. "Dardanët" do të akomodohen në hotel "Emerald", derisa stërvitja e parë zhvillohet të hënën në orën 18:00, në stadiumin "Fadil Vokrri". Përzgjedhësi Challandes të hënën në orën 11:00 do të paraqitet në konfer-

encë për media në hotel "Emerald".

Lista e futbollistëve: Ujkani, Muriq, Bekaj, Rrahmani, Aliti, Vojvoda, Hadergjonaj, Paqarada, Dresheviq, Kololli, Xhemajli, Voca, Rashkaj, Halimi, Berisha, Shala, Celina, Hasani, Zhegrova, Muslija, Rashani, Rashica, Muriqi, Nuhiu.



Wilder: Fury nuk e dëshiron më këtë revansh

WASHINGTON, 8 NËNTOR - Boksieri amerikan Deontay Wilder do ta mbrojë titullin kampion bote në peshën e rëndë, në kategorinë WBC, më 23 nëntor. Ai do të duelojë ndaj kubanezit Luis Ortiz në Las Vegas, një revansh për këtë

të fundit, që kërkon të hakmerret pas humbjes në mars të 2018-s. Gjithsesi, Wilderi e pret një tjetër revansh në shkurt të vitit të ardhshëm, ai ndaj Tyson Fury, sfidë që pritet me më shumë interes se ky që zhvillohet pas dy javësh. Duke

folur për këtë revansh me Tyson Furyn (sfida e parë përfundoi në barazim). "Fury nuk e dëshiron më këtë revansh. Në fakt, ai nuk ka dashur kurrë të duelojë sërish ndaj meje. Shumë njerëz e admirojnë për shkak të rikthimit të tij në ring

pas problemeve që pati, por kjo ndodh në Amerikë, që ndiejmë keqardhje për këta njerëz. Shumë njerëz dëshironin që Fury ta fitonte duelin ndaj meje për shkak të historisë së tij personale", ka thënë Wilder.



